



ALPHA WEB START



Alpha WEB Start-i është një aplikacion në WEB, i ndërtuar enkas për të punuar nëpërmjet internetit si në LAN. Alpha WEB Start-i kryen përfundimisht komunikimin në largësi me pikat e shitjes, me magazinat dhe furnitorët, si dhe me konsulentë të jashtëm: ekspertë kontabël, auditorë etj. Kostumizimi i programit sipas kërkesave të përdoruesit, përditësimet, shtesat dhe mirëmbajtja kryhen të gjitha automatikisht dhe “online”.



INSTITUTI I MODELIMEVE NË BIZNES

www.imb.al
www.alphaweb.al

ÇFARË JANË APLIKACIONET NË WEB?

Aplikacionet në Web janë programe që përdorin teknika dhe struktura të ndërtuara enkas për të punuar nëpërmjet internetit. Ato mundësojnë një shkëmbim aq të shpejtë të informacionit, sa largësia bëhet e papërfillshme. Mund të punosh nga një shtet në tjetrin apo nga një kontinent në tjetrin, njësoj si të ishe i lidhur me kabëll nga një zyrë në tjetrën. Zbatimet në Web kanë shumë përparësi. Ato përbëjnë një hop cilësor në teknikat e programimit, dhe janë e ardhmja e aplikacioneve informatike.

Veçanti të programit Alpha Web Start

Është një aplikacion në Web, që punon “online”. Pra, ju mundëson të punoni, nëpërmjet internetit, kudo që të jeni, sado larg. Dhe, për më tepër, nuk ka rëndësi shpejtësia e internetit. Alpha Web Start-i punon mirë edhe me internetin e shtëpisë apo wireless-in publik.

Ky program ju kursen kohën dhe ul ndjeshëm kostot. Kostumizimi i programit sipas kërkesave të përdoruesit, përditësimet, shtesat dhe mirëmbajtja kryhen të gjitha automatikisht dhe “online”.

Falë teknologjive më të reja në përdorim, programi mundëson një ndërfaqe komunikimi të thjeshtë dhe intuitive. Alpha Web Start-i punon në çdo lloj platforme (Windows, Macintosh, Linux), madje edhe në ato që përdoren në celularë (IOS, Android etj).

Alpha Web Start-i zgjidh përfundimisht komunikimin në largësi me pikat e shitjes, me magazinat dhe furnitorët, si dhe konsulentët tuaj, ekspertë kontabël, auditorë... njësoj si të ishin të gjithë në një zyrë. Të gjithë personat e autorizuar mund të punojnë njëkohësisht me programin. Alpha Web Start-i dallohet, ndër të tjera, se përshtatet lehtësisht me kërkesat tuaja. Madje edhe të dhënat janë më të sigurta. Alpha Web Start-i është i pari i serisë Alpha Web.

Funksionet e Alpha Web Start-it

Alpha Web Start-i ju shërben për të miradministruar biznesin tuaj nga ana materiale e financiare. Ai ka parametrat e nevojshëm për t'u përshtatur me dokumentet tuaja dhe për të marrë të dhënat, sipas formatit që ju nevojitet. Përgjithësisht, ai ka po ato funksione që ka Alpha Start-i, por me një format edhe më komod. Ka përshtatshmëri të madhe me specifikat e biznesit, si dhe një varg funksionesh ndihmëse, që e lehtësojnë mjaft përdorimin.

Funksionet, sipas nevojës së administrimit dhe përdoruesve, grupohen:

- Administrimi
- Inventari
- Shitja / blerja
- Arka / banka
- Kontabiliteti

Administrimi

Administrimi përbëhet nga funksionet që e përshtatin programin me kërkesat e ndërmarrjes për artikujt, klientët a furnitorët, llogaritë, dokumentacionin, përdoruesit etj.

Siguria e të dhënave dhe mbrojtja e tyre nga hyrjet e paautorizuara janë të nivelit bashkëkohor maksimal. Të drejtat e përdoruesve janë përshtatur sipas rolit, mjedisit dhe dokumentit, madje me specifikime të veçanta për çdo individ. Me fjalë të tjera, administratori i programit është i vetmi që ka mundësi të kryejë veprimet e mëposhtme:

- Përcakton përdoruesin, rolin e tij, të drejtat për mjediset ku mund të hyjë, dokumentet dhe veprimet që mund të bëjë: vetëm shikoj, vetëm regjistroj, korrigjoj etj. dhe në cilat ndërmarrje (nëse ka disa ndërmarrje).
- Vendosi dokumentet në disa nivele sigurie regjistrimi (ofertë, fletëshoqërimi, faturë...). Madje krijon modele të veçanta dokumentesh, sipas përdoruesit, për çdo lloj dokumenti, jo vetëm për faturat (shitje, blerje).
- Personalizon dritaret e programit, si një risi tjetër të teknologjisë së përdorur. Ndërfaqet e personalizuara ia lehtësojnë punën përdoruesit duke i automatizuar më tej veprimet e regjistrimit. Për më tepër, ato janë pajisur me mjete ndihmëse sugjeruese e këshilluese.

Ruaj

Shto

Fshi

Klono Te Drejta

-

+

Te perqilthshme

Roli

Ndermarjet

Te Drejta

Ndermarja

IMB shpk

Viti

2011

Text Moduli	Pershkrim Komponente	Te gjitha	Fshirje	Ambienti	Modifikimi
Administrimi		☒	☒	☒	☒
Arka/Banka		☒	☒	☒	☒
Arka/Banka	Arka/Banka	☒	☒	☒	☒
Arka/Banka	Rregjistrime Arke/Banke	☒	☒	☒	☒
Arka/Banka	Lista e dokumentave te arke/banke	☒	☒	☒	☒
Arka/Banka	Rregjistrimi i lidhjes se Dokumentave	☒	☒	☒	☒
Arka/Banka	Lista e Lidhjes se Dokumentave	☒	☒	☒	☒
Kontabiliteti		☒	☒	☒	☒
Raporte		☒	☒	☒	☒
Artikulli		☒	☒	☒	☒
Konfigurime		☒	☒	☒	☒
Blerje		☒	☒	☒	☒
Regjistrime		☒	☒	☒	☒
Lupa		☒	☒	☒	☒
Inventar		☒	☒	☒	☒

Pamje nga mjedisi për konfigurimin e roleve

Inventari

Përmban funksionet që lidhen me veprimet për administrimin e inventarit, si: çelje magazinash e artikujsh, hyrje-daljet në inventar, transferimet nga magazina në magazinë etj.

Artikujt regjistrohen në kartela dhe regjistra nëpërmjet dritareve që ju vetë mund t'i përshtatni lehtësisht sipas nevojës. Mund të shtoni fusha të reja për të dhëna specifike; mund të hiqni fushat që nuk ju duhen; mund të ndryshoni renditjen, madhësinë etj. Për më tepër, mund të ndërtoni modelet tuaja për çdo grup artikulli, që t'i përdorni për artikujt e rinj të atij lloji. Kjo do t'jua lehtësojë mjaft punën.

Dokumentet e lëvizjeve të inventarit (hyrjes, daljes dhe transferimit nga një magazinë në tjetrën), si dhe të gjitha dokumentet e tjera konfigurohen në mjedise mjaft komode. Ato kostumizohen në formë, në përmbajtje dhe në mënyrën e plotësimit. Për automatizimin dhe thjeshtëzimin e regjistrimit të të dhënave mund të vendosni edhe vlera sugjeruese ("default") dhe t'i ndryshoni sipas nevojës. Ju mund t'i përshtatni dritaret për secilën magazinë apo tip artikulli me veçantitë përkatëse.

Regjistrimin e bën shumë komod përdorimi i teknikave inteligjente të sugjerimit ("autocomplete"), si dhe ofrimi i alternativave të reja të regjistrimit, përlogaritjes së kostos dhe kontabilizimit. E tillë është p.sh. llogaritja e inventarit. Sipas parapëlqimit, për secilin artikull, mund të zgjidhni një nga katër mënyrat e llogaritjes së kostos së inventarit. Përveç kësaj, mund të regjistroni edhe dokumente që kanë artikuj të magazinave të ndryshme, pa qenë të detyruar ta ndani atë në dokumente të veçanta për çdo magazinë. Ka edhe lehtësi të tjera.

Shitja / blerja

Përmban: konfigurimin e kartelave të klientëve dhe furnitorëve, modelimin e dokumenteve të shitjes e blerjes dhe të mjediseve të regjistrimit të faturave, regjistrimin e dokumenteve përkatëse, si dhe raportet që lidhen me shitblerjen.

Të gjitha dokumentet e shitblerjes janë lehtësisht të formatueshme sipas kërkesave individuale të biznesit. Përdoruesi mund të përzgjedhë për çdo fushë cilësitë, si: të jetë e dukshme ose jo, të plotësohet automatikisht apo me dorë, të plotësojë disa kushte ose jo etj. Ai mund të ndryshojë renditjen dhe pozicionin e fushave, madhësinë e tyre etj. Shkurt, ta bëjë atë si të dojë.

Madje, çka është më e rëndësishme, përdoruesi mund ta caktojë vetë edhe mënyrën e trajtimit të dokumentit. Pra, nëse duhet të prejë magazinën, nëse duhet të lidhet me fletën e doganës, nëse ka gjendje, nëse ka çmim etj. Sipas skemës së qarkullimit të dokumenteve përshtatet edhe skema e kontabilizimit të tyre. Sipas nevojës mund të krijohen dokumente tip të personalizuar për: blerjet pa artikuj, blerjet me artikuj, blerjet nga importi, shitjet me shumicë, shitjet me pakicë, shitjet me transport, eksportet etj.

Në Alpha Web ka edhe mjaft risi të tjera. E tillë është ruajtja e dokumenteve si "draft" (jo përfundimtare). Po ashtu, edhe në trupin e faturës (në "gridë"), artikujt mund t'i trajtoni ndryshe nga konfigurimi bazë, pra edhe në llogari të ndryshme. Kostumizimi "autocomplete" dhe përparësia e teknologjisë së përdorur ju bën të ndiheni mirë kur punoni. Kjo ndodh sepse edhe funksionet, si: zbritjet analitike, kontrolli i limitit të furnitorit apo klientit, ballafaqimi me ofertën etj, tani janë më komode.

Ruaj

Ruaj Si Draft

Ruaj & Printo

Print preview

Ruaj & Kase

Fshi

Kerko

Fleta Kontabel

Lista

Dokument Kryesor

Fature Shitje

Menkategoria

Fature shitje

Lloji

FSH

Klienti

k001

Emri

klent 001

Numer

3

Pershkrimi

Adresa faturimit

Monedha

LEK

Data

03/10/2011

Numer serial

Kursi

1.00

Pike Shitje

Dege Administrative

Dogana

Jo

Lloji	Kodi	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi	Zbritja	Vlefte pa TVSH	TVSH	Vlefte me TVSH	Fshi
Artikulli	art08	artikulli08	cope	3.00	7.00	0.00	21.00	Nivel 20	25.20	

Menyre pagese

Me mirebesim

Limiti Paralajmerues

0.00

Limiti Bllokues

0.00

Date regjistrimi

03/10/2011

Zbritje ne total

Nentotal

21.00

Perqindje

Vlefte me TVSH

0.00

0.00

Zbritje pa TVSH

TVSH

4.20

Total

25.20

Monedha fature

21.00

Zbritje pa TVSH

0.00

TVSH

4.20

Total

25.20

Pamje nga mjedisi i regjistrimit të shitjes

Arka dhe banka

Këtu bëhen: konfigurimet (çeljet) e arkave dhe llogarive bankare, modelimet e dokumenteve të tyre përkatëse, formatimet e dritareve dhe regjistrimi i dokumenteve përkatëse (mandat arkëtimet, pagesat, çequet, urdhërshirimet etj.), si dhe lidhjet apo varësitë midis tyre.

Risi është mjedisi i krijuar enkas për lidhjen e faturave me pagesat dhe arkëtimet. Ky mjedis mundëson që lidhja e dokumenteve të bëhet edhe më vonë. Edhe trajtimi i gjerë dhe i shumëllojshëm i komisioneve është një komoditet tanimë i kërkuar nga shumë klientë.

Në përgjithësi, funksionet për regjistrimin dhe kontrollin e dokumenteve të likuiditeteve janë pasuruar më tej, në përputhje me llojshmërinë dhe rëndësinë e tyre.

Kontabiliteti

Përmban administrimin e dokumentacionit dhe të veprimeve kontabël, që nga struktura e llogarive, përmbajtja dhe cilësitë e kartelave të llogarive, fletët kontabël, librat dhe dritaret e regjistrimeve të tyre.

Në Alpha Web, mënyra se si kontabilizohet një dokument mundëson administrim financiar shumë më të pasur dhe komod.

Mjedisi i kontabilizimit është i pavarur nga mjedisi i regjistrimit të dokumenteve të tjera. Çdo dokument i regjistruar (faturë, mandat pagesë etj.) që duhet kontabilizuar, gjeneron një dokument të brendshëm kontabël. Kjo e ndan momentin e regjistrimit të dokumentit nga momenti i kontabilizimit të tij dhe i krijon financierit pavarësi të plotë për të vepruar. Financieri mund t'i kontrollojë ato më vonë, një nga një ose të grupuara, dhe të bëjë sistemimet përkatëse.


Edhe më komod është mjedisi i regjistrimit të fletëve kontabël, në mënyrë të veçantë me funksionet e pasuruara të filtrimit, sidomos me krijimin e filtrave të personalizuar, si dhe me funksionet e grupimit (butoni **grupo**).



Raportet

Për çdo aktivitet, njësi apo modul, programi ofron raportet përkatëse, të përgjithshme dhe analitike. Raportet shfaqen shumë shpejt, sado i gjerë të jetë informacioni. Madje ato kanë një sistem bashkëkohor filtrash me tri nivele: kryesorë, të avancuar, të personalizuar.

- **Filtrat kryesorë**, përgjithësisht, janë të domosdoshëm apo përdoren shpesh, si data e dokumentit (periudha nga data ... deri në datën...).
- **Filtrat e avancuar** shërbejnë për të krijuar një raport me përzgjedhje të parametrave (nr. dok.; lloj dok.; klient dhe furnitor; nr. llogarie etj.) brenda vlerave të tyre. Ata mund të kombinohen duke i përzgjedhur jo vetëm në intervale, por edhe si varg vlerash diskrete të shpërndara.
- **Filtrat e personalizuar** janë kombinime të filtrave të mësipërm, që krijohen dhe ruhen për t'i përdorur sa herë që t'ju duhen. Sistemi i filtrave dhe teknikat e reja të përdorura e lehtësojnë shumë personalizimin e raporteve. Ju vetë, pa pasur nevojë për trajnim të posaçëm, duke u nisur nga raporte të gatshme standarde, mund të vendosni filtra që e kostumizojnë raportin.



Cash Flow

Nr.	Emërtimi	Shënime	Viti Raportues	Viti Paraardhës
	Fluksi i parave nga veprimtarite e shfrytëzimit			
+ 1	Paratë e arkëtuara nga klientët		48,052,547.00	
+ 2	Paratë e paguara ndaj furnitorëve dhe punonjësve		(19,933,058.56)	
+ 3	Paratë e arkëtuara nga veprimtaritë		.00	
+ 4	Interesi paguar		(505,823.26)	
+ 5	Tatim fitim I paguar		(7,459,712.00)	
A	Shuma (Para neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit)		20,153,953.18	
	Fluksi i parave nga veprimtaritë investuese			
+ 1	Pagesa për blerje të kompanive të kontrolluara		.00	
+ 2	Pagesa për blerje të aktiveve afatgjatë materiale		.00	
+ 3	Arkëtime nga shitjet e pajisjeve		.00	
+ 4	Interesi I arkëtuar		.00	
+ 5	Dividendë të arkëtuar		.00	
B	Shuma (Para neto nga veprimtaritë investuese)		.00	
	Fluksi i parave nga aktiviteti financiar			
+ 1	Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksioner		.00	
+ 2	Arkëtime nga huamarrje afatgjata		.00	
+ 3	Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		(4,969,979.00)	
+ 4	Dividentë të paguar		(6,300,000.00)	
C	Shuma (Para neto nga aktiviteti financiar)		(11,269,979.00)	
	Te pacaktuara			
+ 1	Arkëtime të pacaktuara		40,536.58	
D	Shuma (Para neto nga të pacaktuara)		(4,969,979.00)	
	Rritja/Rënia neto e mjeteve monetare		8,924,510.76	
	Mjetet monetare në fillim të periudhës		.00	
	Mjetet monetare në fund të periudhës		8,924,510.76	

Pamje nga Raporti i Cash Flow

Zhvendosja e raporteve nga programi në çfarëdo mjedisi tjetër: Excel, Word etj. është mjaft e saktë. Raporteve mund t'u ndryshohet ngjyra, stili dhe përmasa. Gjenerimi i raporteve, pavarësisht nga madhësia e tyre, bëhet në kohë të papërfillshme, në çast.

Përfundime


Me këtë paraqitje të shkurtër nuk mund të vihen në dukje të gjitha risitë dhe përparësitë e këtij programi, që shënon një nivel të ri zhvillimi. Theksojmë se:

- Teknologjia e përdorur ofron një përdorim të lehtë, të shpejtë dhe intuitiv. Ajo është fjala e fundit e së ardhmes së programimit.
- Alpha Web Start-i është software që kapërcen kufijtë e largësisë, të shpejtësisë dhe vëllimit të informacionit. Mjafton të mendoni se nuk bëhet më fjalë për kompjuterë të shtrenjtë, për rrjet që të lidhë kompjuterët me njëri-tjetrin... Ju mund ta përdorni atë edhe nga celulari, (nëse keni autorizimet nga administratori), kudo ku jeni.
- Ky program, ndonëse punon edhe nëpërmjet internetit, është më i sigurt se programet e mëparshme. Të dhënat ("database") janë të mbrojtura po aq sa të dhënat bankare.
- Kushton më lirë dhe kostumizohet më lehtë sipas nevojave tuaja.
- Në fund të fundit është edhe më inteligjent: ju ndihmon me udhëzime, ju korrigjon dhe ju këshillon zgjidhje të gatshme.

Tabelë Krahësuese

	Alpha Platinum	Alpha Web
Puna në largësi	Kërkon rrjet të mirëfilltë LAN ose VPN me karakteristika të larta.	Punon edhe nëpërmjet internetit të zakonshëm në të gjithë browser-at, madje edhe në celular.
Kostumizimi	Mesatar	I lartë, bëhet nga vetë përdoruesi.
Hardware	Instalohet në hardware-in e klientit	Instalohet te klienti ose në hardware profesional me garanci ndërkombëtare.
Mirëmbajtja	Hardware-i dhe databaza kërkojnë mirëmbajtje nga klienti, personel (IT).	Hardware-i, databaza dhe mirëmbajtja e tyre garantohehen nga IMB.
Kostot	Licenca paguhet e plotë që në fillim. Ka kosto mirëmbajtjeje për software dhe hardware.	Mund ta paguani çdo muaj. Nuk ka kosto mirëmbajtjeje për software dhe hardware.
Versionet e reja	Me pagesë ose kontratë mirëmbajtjeje	Falas





për suksesin tuaj!



IMB INSTITUTI I
MODELIMEVE
NË BIZNES

Bulevardi "Gjergj Fishta"
Pall 4, Shk 8, Ap 45
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 22 53 466
+355 69 40 70 148
068 60 79 124
Fax: +355 4 24 27 042
www.imb.al

Kosovë - Prishtinë
IMB Kosovë
Tel: +381 38 71 99 91 / 044 049
177 110
Email: q.surdulli@imbks.com

Vlorë
Rudina LIPI
Cel: 0696166951/0672881555
Email: smebusinessconsulting@gmail.com

Gjirokastrë
Enkela BABARAMO
Cel: 068 60 36 647
E-mail: ebabaramo@yahoo.com

Elbasan
Agim QENANI
Tel: 054 52289 / 066 20 97 406
E-mail: agimqenani@yahoo.it

Korçë
Petri PENO
Tel: 067 25 30 073
E-mail: petri_peno@yahoo.com